

**LIGJ**  
**Nr. 87/2019**

**PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT**  
**TË QARKULLIMIT<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti i ligjit**

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i parimeve, rregullave, kriterëve, detyrimeve, afateve dhe procedurave që duhet të ndiqen nga tatimpaguesit dhe prodhuesit e mirëmbajtësit e zgjidhjeve software-ike, lidhur me lëshimin e faturës, faturën shoqëruese dhe faturën elektronike, përmbajtjen e faturave, regjistrimin e të dhënave dhe procedurën e fiskalizimit të lëshimit të faturave, marrjen e informacionit të pagesave, certifikimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

2. Dispozitat e këtij ligji garantojnë vijimësinë e funksionimit të pajisjeve fiskale përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

**Neni 2**  
**Fusha e veprimit**

Ky ligj zbatohet për:

- a) të gjithë tatimpaguesit që lëshojnë faturë, sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar;
- b) organet publike;
- c) bankat, institucionet financiare jobankare dhe subjekte të tjera, që ofrojnë shërbime pagesash të faturave elektronike.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

---

<sup>1</sup> Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- Direktivën 2014/55 BE të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 16 prill 2014, "Mbi faturimin elektronik në prokurimin publik", Numri CELEX 32014L0055, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 133, datë 6.5.2014, faqe 1-11.

- Direktivën e Këshillit 2006/112/KE, datw 28 nëntor 2006 "Mbi sistemin e përbashkët të taksës mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, Numri CELEX 320006L0012, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 347, datë 11.12.2006,, faqe 1-118.

Në këtë ligj termat e mëposhtme kanë këto kuptimet:

a) “Fiskalizimi i faturave në furnizimin e mallrave e të shërbimeve dhe i faturës shoqëruese” është një sërë masash të zbatuara nga tatimpaguesit, që kanë detyrimin e lëshimit të faturave dhe faturave shoqëruese, për të mundësuar kontrollin efikas të qarkullimit, të realizuar me para në dorë apo në forma të pagesave pa para në dorë dhe kontrollin e lëvizjes së mallrave.

b) “Faturë” është çdo dokument në letër ose në formë elektronike, që përmbush kushtet e përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

c) “Faturë elektronike” është fatura e lëshuar, dërguar dhe pranuar në format elektronik, që lejon përpunimin e saj automatik dhe elektronik.

ç) “Faturë shoqëruese” është një dokument transporti, që përdoret për shoqërimin e lëvizjes së mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, kur nuk ka transferim të pronësisë mbi mallrat.

d) “Lëshuesi i detyrueshëm i një fature elektronike” është personi i cili, sipas këtij ligji, është i detyruar të lëshojë faturë elektronike.

Pranuesi i detyrueshëm i një fature elektronike është blerësi, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

dh) “Nënshkrimi elektronik” ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin për nënshkrimin elektronik dhe legjislacionin për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

e) “Numri identifikues i veçantë i faturës (NIVF)” dhe “Numri identifikues i veçantë i faturës shoqëruese (NIVFSH)” janë të dhëna të veçanta dhe të papërsëritshme alfanumerike të çdo fature dhe fature shoqëruese, të lëshuar nga tatimpaguesi. Këto të dhëna i gjeneron sistemi informatik i administratës tatimore qendrore, sipas rregullave të caktuara, nëse përmbushen të gjitha kontrollet gjatë procesit të verifikimit të faturës dhe faturës shoqëruese.

ë) “Numri i sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF)” dhe “Numri i sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH)” janë të dhëna të veçanta dhe të papërsëritshme alfanumerike të çdo fature dhe fature shoqëruese. Këto të dhëna gjenerohen nga sistemi i tatimpaguesit, lëshues i faturës dhe faturës shoqëruese, duke konfirmuar lidhjen ndërmjet tatimpaguesit dhe faturës ose faturës shoqëruese të lëshuar.

f) “Numri unik i identifikimit” është numri personal identifikues i një individi, ose NIPT/NUIS, me të cilin pajisen personat fizikë dhe juridikë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për regjistrimin e biznesit dhe për procedurat tatimore. Për personin jorezident, i cili nuk është i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, nuk është pajisur me numrin e tij të identifikimit ose NIPT/NUIS dhe nuk është subjekt i tatimeve në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin tatimor, për qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit, numri unik i identifikimit konsiderohet numri identifikues tatimor ose numri identifikues personal i lëshuar në vendin e tij të rezidencës.

g) “Operator” është individi, që përpilon dhe lëshon fatura nëpërmjet sistemit fiskal, ose personi i autorizuar nga tatimpaguesi, që lëshon faturë, për të lëshuar fatura nëpërmjet sistemit fiskal. Në rastet e shitjeve nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automatët), operator konsiderohet tatimpaguesi që lëshon faturën. Në rastet e lëshimit të faturës shoqëruese, operatori është individi, i cili lëshon faturën shoqëruese nga pajisja elektronike.

gj) “Pagesë me para në dorë” është pagesa për mallrat ose shërbimet e furnizuara, kryer me kartëmonedha ose monedha, të cilat konsiderohen mjete të ligjshme pagese, në përputhje me legjislacionin përkatës dhe, për qëllim të këtij ligji, përfshijnë edhe kartat e debitit, kreditit dhe çequet.

h) “Pagesë pa para në dorë” është pagesa për mallrat ose shërbimet e furnizuara, kryer nëpërmjet një banke, institucioni financiar jobankar ose subjekteve të tjera, që ofrojnë

shërbime pagese, ose institucioneve të tjera të parasë elektronike, të licencuara nga Banka e Shqipërisë dhe që, për qëllim të këtij ligji, përfshin të gjitha mënyrat e tjera të pagesës, të cilat nuk konsiderohen pagesa me para në dorë, sipas pikës “gj” të këtij neni.

i) “Platforma qendrore e faturave” është platforma që krijohet, zhvillohet, mirëmbahet dhe administrohet nga ana teknike nga institucioni përgjegjës për administrimin e infrastrukturës, të sistemeve dhe shërbimeve TIK (AKSHI). Të dhënat që shkëmbehen nëpërmjet kësaj platforme administrohen nga administrata tatimore qendrore dhe përfshijnë:

i. një platformë të veçantë, për nevoja të zbatimit të këtij ligji, në të cilën çdo tatimpagues, që lëshon fatura, paraqet informacionin e kërkuar, në përputhje me këtë ligj, shqyrton të gjitha faturat e fiskalizuar, në të cilat paraqitet si blerës ose si shitës, paraqet ose shikon të gjitha pagesat e regjistruara të faturave elektronike. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura, në përputhje me këtë ligj, mund të përpilojnë fatura, të kryejnë procedurën e fiskalizimit, të lëshojnë faturën ose faturën elektronike dhe të dërgojnë e të pranojnë faturën elektronike drejtpërdrejt në këtë platformë. Çdo tatimpagues, që lëshon fatura, mund të shikojë e të shtojë të dhëna shtesë në librin e shitjes e të blerjes, nëpërmjet llogarisë personale të krijuar në këtë platformë;

ii. ndërfaqja për shkëmbimin e faturave elektronike, në përputhje me këtë ligj.

j) “Rezidentët dhe jorezidentët për qëllime tatimore” përcaktohen sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.

k) “Sistemi i fiskalizimit” është tërësia e pajisjeve fiskale dhe zgjidhjeve software-ike që mund të përfshijë dhe çdo zgjidhje software-ike të ndërmjetme që përdoren për lëshimin dhe marrjen e faturave e të faturave shoqëruese, zbatimin e procedurave të fiskalizimit dhe shkëmbimit elektronik të mesazheve, komunikimit ndërmjet tatimpaguesve që lëshojnë fatura, fatura shoqëruese, dhe sistemit të teknologjisë së informacionit të administratës tatimore qendrore, duke përdorur një rrjet të sigurt të shkëmbimit të të dhënave nëpërmjet lidhjes elektronike, internetit. Sistemi i fiskalizimit përdoret, gjithashtu, për shkëmbimin elektronik të mesazheve dhe komunikimin ndërmjet bankave, institucioneve financiare jobankare dhe subjekteve të tjera, që ofrojnë shërbime pagese të faturave elektronike, dhe sistemit të teknologjisë së informacionit të administratës tatimore qendrore. Sistemi i fiskalizimit përfshin:

i. pajisjen fiskale, e cila përbëhet nga:

- pajisja elektronike e faturimit, që përdoret për lëshimin e faturave për shitjen e mallrave dhe ofrimin e shërbimeve, me memorie për regjistrimin e të dhënave fiskale në faturat e lëshuara për pagesa që kryhen me para në dorë;

- pajisja elektronike për lëshimin e faturës shoqëruese, me memorie për regjistrimin e të dhënave fiskale në faturat shoqëruese të lëshuara;

- printeri për lëshimin e faturave nëpërmjet pajisjes elektronike të faturimit ose për lëshimin e faturës shoqëruese, në rast se printeri nuk është pjesë e pajisjes elektronike të faturimit ose pajisjes elektronike;

- çdo pajisje elektronike, që përdoret për të përpiluar dhe lëshuar fatura për shitjen e mallrave apo ofrimin e shërbimeve për pagesa që kryhen pa para në dorë;

- çdo pajisje elektronike e përdorur për të regjistruar pagesa pa para në dorë të faturave elektronike;

ii. zgjidhjen software-ike, në formën e një aplikacioni individual, ose të një sistemi të integruar kompjuterik apo një aplikacioni Cloud, i cili mundëson:

- përpilimin e faturës ose faturës shoqëruese, futjen e të gjitha elementeve të domosdoshëm të faturës ose faturës shoqëruese;

- identifikimin e operatorit që lëshon faturën ose faturën shoqëruese;

- nënshkrimin elektronik;

- lëshimin dhe pranimin e faturave elektronike;

- transferimin automatik të të dhënave në administratën tatimore qendrore dhe pranimin e informacionit konfirmues nga administrata tatimore qendrore, pas verifikimit automatik të çdo fature ose fature shoqëruese;

- ruajtjen e të dhënave në memorie;

- masa të tjera për procedurën e fiskalizimit;

iii. zgjidhjen software-ike, në formën e një aplikacioni individual ose të një sistemi të integruar kompjuterik apo një aplikacioni Cloud, që mundëson nënshkrimin elektronik, transferimin automatik të të dhënave në administratën tatimore qendrore dhe pranimin e mesazhit konfirmues nga administrata tatimore qendrore, pas verifikimit automatik të mesazhit të pagesës së një fature elektronike;

iv. sistemin e komunikimit ndërmjet tatimpaguesit, që lëshon fatura ose fatura shoqëruese, dhe administratës tatimore qendrore apo ndërmjet bankave, institucioneve financiare dhe ndërmjetësve të tjerë, të cilët ofrojnë shërbime pagese të faturave elektronike dhe administratës tatimore qendrore, nëpërmjet rrjetit të sigurt për transferimin elektronik të të dhënave në internet.

l) “Tatimpagues” është personi juridik apo fizik, që ka detyrimin të lëshojë faturë ose faturë shoqëruese, sipas këtij ligji ose legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

ll) “Vend i ushtrimit të veprimtarisë” është:

i. çdo vend i mbyllur ose i hapur dhe çdo pajisje vetëshërbimi (automat), që shfrytëzohet për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të mallrave apo ofrimit të shërbimeve;

ii. një ose disa pjesë të ambienteve të një biznesi, në të cilën i njëjti tatimpagues, që duhet të lëshojë faturë, në përputhje me këtë ligj, ushtron veprimtari të ndryshme, të cilat i deklaron sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe që, për qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit, mund të konsiderohen vende të veçanta të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;

iii. çdo vend, të cilin tatimpaguesi e përdor për ushtrimin e përkohshëm të një veprimtarie ose e përdor herë pas here, me qëllim të organizimit të panairove apo aktiviteteve të tjera të ngjashme;

iv. çdo vend i biznesit për aktivitete të kryera në terren ose në vendndodhjen e klientit, nëse pagesa për shërbimet e kryera apo mallrat e dorëzuara bëhet me para në dorë drejtpërdrejt në vendin ku janë furnizuar mallrat apo shërbimet;

v. çdo mjet i lëvizshëm i biznesit, që shërben për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të mallrave dhe shërbimeve;

vi. vendi i regjistruar i veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit, nëse aktiviteti lidhet ekskluzivisht me shërbimet elektronike, dhe në të gjitha rastet kur natyra e veprimtarisë ekonomike nuk kërkon një hapësirë veprimtarie specifike dhe të ndarë;

vii. për qëllim të monitorimit të lëvizjes së mallrave, për të cilat është lëshuar fatura shoqëruese, sipas shkronjës “ç”, të këtij neni, vendndodhje e biznesit konsiderohet, gjithashtu, çdo dyqan apo vend ku mallrat janë magazinuar dhe merren për transport;

m) “Kodi QR” është: një barkod dydimensional i përgjigjes së shpejtë, që përdoret për të aksesuar në mënyrë të thjeshtë dhe të shpejtë informacionin.

## KREU II

### DETYRIMI PËR TË LËSHUAR FATURË

#### Neni 4

#### **Tatimpaguesit që duhet të lëshojnë faturë**

Tatimpaguesit, që duhet të lëshojnë faturë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor i realizuar në vitin paraardhës ose në atë aktual, janë personat juridikë dhe fizikë:

a) të cilët janë tatimpagues të tatimit mbi fitimin, në përputhje me ligjin për tatimin mbi të ardhurat;

b) të cilët janë tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sistemin e taksave vendore;

c) të cilët janë tatimpagues që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar, pavarësisht nga forma e organizimit, përfshirë organizatat jofitimprurëse, njësitë e zbatimit të projekteve, organet publike qendrore e vendore, organizatat politike dhe institucione të tjera të ngjashme;

ç) të cilët janë tatimpagues rezident ose jorezident, pavarësisht nga forma e organizimit, kur furnizojnë mallra ose shërbime për organet publike, përveçse kur një organ publik i nënshtrohet TVSH-së dhe ka detyrimin të lëshojë një faturë si marrës i mallrave ose shërbimeve;

d) të cilët janë tatimpagues jorezidentë, për furnizimin e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, kur, në përputhje me legjislacionin tatimor, sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b” e “c”, të këtij neni, u nënshtrohen detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet një përfaqësuesi tatimor.

#### Neni 5

#### **Tatimpaguesit që përjashtohen nga detyrimi për të lëshuar faturë**

1. Përjashtimisht përcaktimeve në nenin 4, të këtij ligji, tatimpaguesi nuk është i detyruar të lëshojë faturë për llojet e veprimtarive dhe për furnizimin e mallrave e të shërbimeve si më poshtë:

a) për prodhuesit bujqësorë, që janë ose jo subjekte të skemës së kompensimit, në përputhje me legjislacionin për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë;

b) për shitjen e biletave ose kuponave nga shoferi i një mjeti transporti pasagjerësh në linjat e transportit publik urban, në përputhje me vendimet e njësisë të vetëqeverisjes vendore;

c) për furnizimin e mallrave e të shërbimeve nga persona fizikë të regjistruar në administratën tatimore si “ambulantë”.

2. Përveç përjashtimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, tatimpaguesi nuk është i detyruar të lëshojë faturë edhe për rastet e tjera të përjashtimit nga ky detyrimin, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

#### KREU III

#### **LËSHIMI I FATURËS**

#### Neni 6

#### **Rregulla të përgjithshme për lëshimin e faturës**

1. Tatimpaguesit e përcaktuar në nenin 4, të këtij ligji, janë të detyruar të lëshojnë faturë për çdo furnizim mallrash apo shërbimesh që është pjesë e veprimtarisë së tyre ekonomike. Furnizimi i mallrave dhe/ose furnizimi i shërbimeve dhe veprimtaria ekonomike përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Faturat e lëshuara sipas pikës 1, të këtij neni, përdoren për kontrollin e përmbushjes së kushteve për lehtësimin e detyrimeve tatimore ose përjashtimet nga to, për përlogaritjen e detyrimeve tatimore, në përputhje me ligjet përkatëse.

3. Shitësi duhet të lëshojë dhe blerësi duhet të kërkojë faturën në kohën e furnizimit të mallit apo të shërbimit. Fatura përgatitet nga shitësi dhe merret e ruhet nga blerësi në formën

originale dhe nga shitësi në letër ose si e dhënë elektronike në sistemin e tij elektronik, të përdorur për të lëshuar apo ruajtur faturat.

4. Fatura mund të lëshohet edhe nga një palë e tretë, e autorizuar, në emër dhe për llogari të shitësit ose tatimpaguesit që lëshon faturë.

5. Fatura mund të lëshohet nga blerësi për mallrat apo shërbimet e marra (vetëfaturim) nga një tatimpagues, nëse ka një marrëveshje paraprake ndërmjet dy palëve dhe me kusht që të ekzistojë një procedurë për pranimin nga furnizuesi i mallrave ose shërbimeve të çdo fature të lëshuar në emër dhe për llogari të tij.

6. Vlerat e treguara në faturë mund të shprehen në çfarëdo lloj monedhe, me kusht që vlera totale, vlera e tatueshme, dhe vlera e pagueshme e TVSH-së të shprehen në vlerën ekuivalente në monedhën kombëtare shqiptare (LEK), sipas kursit të këmbimit të publikuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë në momentin kur është lëshuar fatura. Në rast të importimit të mallrave, vlera ekuivalente në monedhën kombëtare shqiptare (LEK) shprehet sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë.

7. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat për nxjerrjen e udhëzimit përkatës për zbatimin e këtij neni.

#### Neni 7

### **Rregulla të veçanta për lëshimin e faturës**

1. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura, janë të detyruar të lëshojnë një faturë edhe për çdo pagesë të bërë përpara kryerjes së furnizimit të mallrave ose përpara përfundimit të furnizimit të shërbimeve.

2. Përveç detyrimit të lëshimit të faturave për çdo furnizim të mallrave ose ofrimit të shërbimeve, tatimpaguesit, subjekte të TVSH-së ose të tatimit mbi fitimin, apo të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për biznesin e vogël, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi, detyrohen të lëshojnë faturë si pranues të mallrave apo shërbimeve të furnizuara kur:

a) blejnë mallra ose shërbime nga individë që nuk kanë cilësinë e tregtarit dhe që nuk janë të regjistruar në administratën tatimore si tatimpagues që lëshojnë fatura, me kusht që fatura të përmbajë informacionin dhe të dhënat e parashikuara në këtë ligj;

b) në kuadër të veprimtarisë ekonomike të tyre, blejnë shërbime të furnizuara nga një person i tatueshëm, që nuk është i vendosur brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç nëse ky person i tatueshëm, shitësi nga jashtë, lëshon një faturë elektronike, në përputhje me specifikimet teknike të përfshira në Standardet Shqiptare (SSH), siç janë publikuar nga institucioni përgjegjës për standardizimin, që shkëmbehet nëpërmjet platformës qendrore të faturave, në përputhje me nenin 26 të këtij ligji;

c) blejnë mallra nga prodhuesit bujqësorë, që janë subjekte të skemës së kompensimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

3. Ministri përgjegjës për financat, përcakton me udhëzim zbatimin e këtij neni në lidhje me procedurën e vetëfaturimit, në rastin e blerjes së shërbimeve nga tatimpaguesit jashtë vendit, si dhe procedurën për shkëmbimin e faturave elektronike nëpërmjet platformës qendrore të faturave, për shitësit dhe lëshuesit e faturave nga jashtë vendit.

#### Neni 8

### **Momenti i lëshimit të faturës**

1. Fatura duhet të lëshohet në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

2. Në rastin kur blerësi ose marrësi i mallrave ose shërbimeve lëshon një faturë sipas shkronjave “a” dhe “c”, të pikës 2, të nenit 7, të këtij ligji, kjo faturë lëshohet menjëherë, në momentin e furnizimit të mallit apo shërbimit nga blerësi.

3. Në rast se blerësi ose marrësi i shërbimeve lëshon një faturë në përputhje me shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 7, të këtij ligji, fatura lëshohet nga blerësi jo më vonë se data 10 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer shërbimi.

4. Në rastin e referuar në pikën 1, të nenit 7, të këtij ligji, fatura lëshohet menjëherë dhe, në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas pranimit të pagesës.

5. Nëse mallrat furnizohen pa transport, atëherë shitësi duhet të lëshojë faturën në momentin kur mallrat i vihen në dispozicion blerësit.

6. Fatura mund të lëshohet në mënyrë periodike për disa furnizime mallrash ose shërbimesh, të cilat furnizohen në mënyrë të rregullt apo të vazhdueshme, të realizuara ndërmjet tatimpaguesit, që lëshon fatura, dhe klientit të tij, në të njëjtin muaj në të cilin janë kryer furnizimet. Në këtë rast, fatura duhet të lëshohet në mënyrë mujore, jo më vonë se dita e dhjetë e muajit që pason muajin në të cilin është kryer furnizimi.

7. Pika 6, e këtij neni, nuk zbatohet për faturat elektronike të lëshuara në lidhje me procedurat e prokurimit publik.

8. Përveç parashikimeve të këtij neni, tatimpaguesit, subjekte të TVSH-së, duhet të lëshojnë fatura për raste të tjera të paspecifikuara në këtë nen, në momentin siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

## KREU IV

### PËRMBAJTJA E FATURËS

#### Neni 9

#### **Të dhënat e përgjithshme të faturës**

1. Fatura e lëshuar përpilohet në formën e caktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat dhe përmban, të paktën, informacionin e mëposhtëm:

- a) titullin “Faturë tatimore”;
- b) datën dhe kohën e lëshimit të faturës (orën, minutat dhe sekondat);
- c) numrin e faturës;
- ç) numrin unik të identifikimit të shitësit;
- d) emrin e tatimpaguesit/emrin dhe mbiemrin e shitësit;
- dh) adresën e shitësit;
- e) numrin unik të identifikimit të blerësit, emrin e tatimpaguesit/emrin, mbiemrin dhe adresën e blerësit. Këto të dhëna janë të detyrueshme vetëm në rast se blerësi është:
  - i. tatimpagues, subjekt i tatimit mbi fitimin, tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për biznesin e vogël, ose subjekt i TVSH-së, në përputhje me legjislacionin përkatës;
  - ii. person juridik;
  - iii. person që blen pronë personale, me vlerë individuale mbi 500 000 lekë;
  - iv. në raste të tjera, kur blerësi kërkon shënimin e këtyre të dhënave në faturë;
- ë) kodin e operatorit, të përcaktuar në përputhje me nenin 15 të këtij ligji;
- f) kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, të përcaktuar në përputhje me nenin 14 të këtij ligji;
- g) datën ose periudhën në të cilën furnizimi i mallrave apo shërbimeve është kryer, ose datën në të cilën është kryer pagesa në llogarinë e referuar në pikën 1, të nenit 7, të këtij ligji, për sa kohë kjo datë mund të përcaktohet dhe në qoftë se ajo është e ndryshme nga data e lëshimit të faturës;

gj) sasinë dhe përshkrimin e mallrave ose të shërbimeve të furnizuara dhe çmimin për njësi;

h) vlerën e plotë;

i) rritjet ose zbritjet e tjera të zbatuara (informacion mbi kompensimin ose pagesën, nëse është rasti);

j) vlerën totale për t'u paguar;

k) të dhënat e pagesës, përfshirë mënyrën e pagesës (kartëmonedha dhe monedha, kartë, çek, transaksion bankar, urdhërpagesë, para elektronike, mënyra të tjera të pagesës pa para në dorë), monedhën dhe kursin e këmbimit, nëse fatura nuk është e shprehur në monedhën kombëtare shqiptare (LEK), dhe afatin e pagesës, në rast se pagesa nuk kryhet në çastin e lëshimit të faturës;

l) numrin identifikues të veçantë të faturës (NIVF), të shprehur si shenjë alfanumerike;

ll) numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF), të shprehur si shenjë alfa numerike;

m) kodin QR, i cili përmban të dhënat e përcaktuara me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

n) shkallën e aplikuar të TVSH-së.

2. Në rast të eksportimit të mallrave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, përveç informacionit të referuar në pikën 1, të këtij neni, fatura duhet të përfshijë edhe emrin e tatimpaguesit/emrin, mbiemrin dhe adresën e blerësit, nëse ai është tatimpagues ose person juridik në vendin e tij rezident, si dhe numrin e identifikimit tatimor të lëshuar në vendin e tij të rezidencës. Nëse blerësi është individ, i cili nuk është tatimpagues në vendin e tij të rezidencës, në faturë shënohet emri i tij i plotë dhe adresa ku dërgohen mallrat.

3. Çdo dokument në letër ose formë elektronike, që ndryshon faturën origjinale dhe që i referohet në mënyrë specifike e të qartë kësaj fature, konsiderohet si faturë dhe duhet të përmbajë të gjitha elementet, në përputhje me këtë ligj, si dhe referencën të fatura origjinale.

4. Përveç informacionit të përmendur në pikën 1, të këtij neni, kur fatura lëshohet nga blerësi për furnizimin e marrë nga shitësi, fatura e lëshuar duhet të përmbajë edhe shënimin "Vetëfaturim". Në këtë rast, është e detyrueshme të përfshihet në faturë edhe informacioni me numrin unik të identifikimit, emrin e tatimpaguesit/emrin, mbiemrin dhe adresën e shitësit.

5. Përveç të dhënave të detyrueshme, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, tatimpaguesit, që lëshojnë faturë, mund të përfshijnë edhe të dhëna të tjera, sipas nevojave të tyre.

6. Tatimpaguesit, që lëshojnë faturë, janë të detyruar që të paraqesin informacion të saktë e të plotë, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

7. Çdo blerësi, person fizik apo juridik, ose individ, i lind e drejta të mos kryejë transaksionin për vlerën e mallit apo të shërbimit të ofruar nëse shitësi nuk lëshon një faturë me të gjitha të dhënat e detyrueshme, në përputhje me këtë ligj.

8. Shënimet NIVF dhe NSLF, së bashku me informacionet e tjera të detyrueshme, sipas këtij neni, duhet të printohen së bashku me elementet e tjera të faturës, kur fatura lëshohet në letër, ose të përfshihen në faturën elektronike.

9. Fatura që nuk është lëshuar ose për të cilën nuk është kryer procedura e fiskalizimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, nuk njihet si një dokument i vlefshëm për qëllime tatimore për një blerës që kryen aktivitet tregtar.

10. Përveç përshkrimeve dhe të dhënave të parashikuara në pikat 1 e 2, të këtij neni, fatura me TVSH përmban të dhënat e përcaktuara në legjislacionin për tatimin mbi vlerën e shtuar.

11. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton mënyrën e gjenerimit, gjatësinë dhe llojin e të dhënave për NIVF-në dhe NSLF-në, si dhe mund të përcaktojë kërkesa të tjera që duhet të përmbajë një faturë, për rastet që rrjedhin nga veçoritë e veprimtarive të zhvilluara, të sendeve të tregtueshme, të punimeve apo të shërbimeve.



Neni 10  
**Të dhënat shtesë për faturën elektronike**

1. Përveç përshkrimeve dhe të dhënave të parashikuara në nenin 9, këtij ligji, fatura elektronike përmban të dhënat për procesin, identifikuesit e faturës, adresat elektronike të shitësit e të blerësit në platformën qendrore të faturave dhe, nëse është e aplikueshme:

- a) të dhënat e përfituesit të pagesës;
- b) të dhënat e përfaqësuesit tatimor të shitësit;
- c) referencën e kontratës;
- ç) të dhënat e dorëzimit;
- d) detajet e çmimit.

2. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton elementet teknike dhe procedurën për lëshimin e shkëmbimin e faturave elektronike e të dokumenteve shoqëruese.

Neni 11  
**Fatura e thjeshtë**

1. Si përjashtim nga neni 9, i këtij ligji, tatimpaguesi që lëshon fatura, i cili i nënshtrohet regjimit të bizneseve të vogla, sipas legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar, mundet që në rastin e furnizimit të mallrave e të shërbimeve të paguara me para në dorë, në kohën e dorëzimit të mallrave ose të shërbimeve të lëshojë një faturë të thjeshtuar, e cila duhet të përmbajë, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

- a) titullin “Faturë-Th”;
- b) numrin e faturës;
- c) kodin e operatorit, të lëshuar në përputhje me nenin 15 të këtij ligji;
- ç) kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, të përcaktuar në përputhje me nenin 14 të këtij ligji;
- d) mënyrën e pagesës (kartëmonedha, kartë, çek), monedhën dhe kursin e këmbimit, nëse fatura nuk është e shprehur në monedhën kombëtare shqiptare (LEK);
- dh) NIVF-në;
- e) NSLF-në;
- ë) datën dhe kohën (orën, minutat dhe sekondat) e lëshimit të faturës;
- f) identifikimin e shitësit (numrin identifikues unik, emrin e tatimpaguesit/emrin dhe mbiemrin, dhe adresën);
- g) identifikimin e blerësit (numrin identifikues unik, emrin e tatimpaguesit/emrin dhe mbiemrin, dhe adresën). Ky informacion është i detyrueshëm vetëm në rast se blerësi është tatimpagues, subjekt i tatimit mbi fitimin, tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, ose subjekt i TVSH-së, në përputhje me ligjet e veçanta, ose është person juridik, që është furnizuar me mallra apo shërbime në territorin e Republikës së Shqipërisë, me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë së tij ekonomike; ose në raste të tjera, kur blerësi kërkon shënimin e këtyre të dhënave në faturë;
- gj) sasinë dhe përshkrimin e mallrave apo të shërbimeve të furnizuara dhe çmimin për njësi;
- h) vlerën totale të faturës;
- i) kodin QR, i cili përmban të dhënat e përcaktuara me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

2. Në rastin kur fatura lëshohet në letër, nuk është e nevojshme të përfshihen të dhënat, sipas shkronjave “b” deri në “d”, të pikës 1, të këtij neni, sepse blerësi mund t’i aksesojë ato nëpërmjet kodit QR, në përputhje me shkronjën “i”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Në rast të vetëfaturimit, i cili përmban detyrimin e TVSH-së, lëshohet një faturë me TVSH, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

4. Përveç elementeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar, fatura e thjeshtuar e TVSH-së duhet të përfshijë të dhënat, sipas shkronjave “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e” dhe “i”, të pikës 1, të këtij neni. Pika 2, e këtij neni, zbatohet edhe për faturat e thjeshtuara të TVSH-së.

## Neni 12 **Numri i faturës**

1. Numri i faturës, i cili, sipas dispozitave të nenit 9, të këtij ligji, është pjesë integrale e faturës, duhet të paraqitet nga tatimpaguesi që lëshon fatura në fushën “numri i faturës”, gjatë zbatimit të procedurës së fiskalizimit, dhe në faturë në dy pjesë:

- a) numrin rendor numerik të faturës;
- b) kodin e pajisjes elektronike të faturimit.

2. Renditja numerike e numrit të faturës duhet të formohet si një renditje numerike e pandërprerë, pa hapësira ndërmjet numrave, për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë të biznesit ose pajisje elektronike të faturimit brenda vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit. Rregullat e renditjes numerike të numrit të faturës duhet të përshkruhen nga tatimpaguesi që lëshon fatura në një akt të brendshëm.

3. Renditja numerike e pandërprerë për çdo vit kalendarik fillon nga numri “1” deri në numrin “n”, për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit ose pajisje elektronike të faturimit brenda vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

4. Kodi i pajisjes elektronike të faturimit gjenerohet nga sistemi informatik i administratës tatimore qendrore, në momentin e testit të parë të hyrjes gjatë regjistrimit të pajisjes elektronike të faturimit, që duhet të kryhet jo më vonë se 24 orë përpara lëshimit të faturave nga ajo pajisje. Ndër elementet e tjera që duhet të përmbajë ky test hyrje, përcaktuar në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, përfshihet, gjithashtu, kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit ku do të përdoret pajisja elektronike e faturimit.

5. Numri i faturës tregohet pa kodin e pajisjes elektronike të faturimit, të referuar në shkronjën “b”, të pikës 1, të këtij neni, në rastin e:

- a) lëshimit të faturës, për të cilën është parashikuar pagesa pa para në dorë;
  - b) përpilimit dhe lëshimit të faturës nëpërmjet platformës qendrore të faturave, në përputhje me nenin 22 të këtij ligji;
  - c) vetëfaturimit, sipas pikës 2, të nenit 7, të këtij ligji.
6. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton zbatimin e këtij neni.

## KREU V **REGJISTRIMI I TË DHËNAVE**

### Neni 13 **Të dhënat e tatimpaguesve që lëshojnë fatura**

1. Tatimpaguesit, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të regjistruar si tatimpagues aktivë në administratën tatimore dhe janë subjekt i lëshimit të faturave sipas nenit 4, të këtij ligji, regjistrohen automatikisht në regjistrin e tatimpaguesve që mban administrata tatimore qendrore si tatimpagues që lëshojnë fatura.

2. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjithë tatimpaguesit e rinj, të cilët do të regjistrohen në regjistrin tregtar pranë institucionit përgjegjës për regjistrin tregtar, regjistrohen automatikisht si tatimpagues që lëshojnë faturë në regjistrin e tatimpaguesve, që mbahet nga administrata tatimore qendrore. Parashikimet e kësaj pike zbatohen automatikisht edhe për tatimpaguesit që kalojnë nga regjistri pasiv në regjistrin aktiv.

3. Për të gjithë personat e rinj fizikë dhe juridikë, të regjistruar në administratën tatimore pas datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, si dhe ata që kalojnë nga regjistri pasiv në regjistrin aktiv, përcaktimi i tyre si tatimpagues që lëshojnë fatura në regjistrin e tatimpaguesve që mbahet nga administrata tatimore qendrore bëhet automatikisht nga administrata tatimore qendrore, bazuar në vlerësimin e bërë në momentin e regjistrimit ose në bazë të kërkesës së atij personi. Kërkesa bëhet në mënyrë elektronike, nëpërmjet platformës qendrore të faturave, në momentin e fillimit të furnizimit të mallrave e shërbimeve, në bazë të të cilave ata persona detyrohen të lëshojnë fatura në përputhje me këtë ligj, dhe jo më vonë se 24 orë përpara lëshimit të faturës së parë. Përgjashtimisht, në rastet e përcaktuara në nenin 31, të këtij ligji, kërkesa mund të paraqitet personalisht në administratën tatimore, bazuar në vendin e tyre të regjistrimit, ose adresën e përhershme apo vendbanimin e zakonshëm.

4. Administrata tatimore qendrore, për të gjithë personat sipas pikës 3, të këtij neni, kryen regjistrimin e detyrimit të tyre për lëshimin e faturave në regjistrin e saj. Në këtë rast, tatimpaguesi nuk do të pajiset me vërtetim apo numër fiskal të veçantë dhe gjatë lëshimit të faturave do të përdorë numrin e vet unik të identifikimit.

#### Neni 14

#### **Regjistrimi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit dhe i pajisjeve elektronike e faturimit**

1. Tatimpaguesi, që lëshon fatura, detyrohet të paraqesë nëpërmjet platformës qendrore të faturave të dhënat për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, jo më vonë se 24 orë përpara fillimit të lëshimit të faturës sipas këtij ligji, në çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

2. Për qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit të lëshimit të faturave, regjistrimi sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të përmbajë, së paku, të dhënat e mëposhtme:

- a) numrin unik të identifikimit të tatimpaguesit që lëshon faturën;
- b) emrin tregtar të vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, nëse ka;
- c) adresën e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- ç) llojin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- d) llojin e veprimtarive që ushtron në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- dh) orarin ditor të punës dhe ditët e punës gjatë javës, punën gjatë festave zyrtare;
- e) datën e fillimit të ushtrimit të veprimtarisë në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- ë) datën e mbylljes së veprimtarisë në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, duke përfshirë datat e ndërprerjes së përkohshme, kur është rasti;
- f) sipërfaqen e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, kur kjo është e mundur;
- g) mënyrën e pagesës së pranuar për furnizimin e mallrave ose të shërbimeve në atë vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit (me para në dorë dhe/ose pa para në dorë);
- gj) statusin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit;
- h) emrin e ofruesit të lidhjes elektronike (internetit);
- i) shënimin nëse vendi i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit është në pronësi ose me qira.

3. Tatimpaguesi, që lëshon fatura, të dhënat për llojin e veprimtarive që ushtron në vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, sipas shkronjës “d”, të pikës 2, të këtij neni, i paraqet sipas përcaktimeve të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike në fuqi.

4. Si përjashtim nga pika 1, e këtij neni, nëse tatimpaguesi, që lëshon fatura, nuk mund të përdorë platformën qendrore të faturave në rastet e specifikuara në nenin 31, të këtij ligji, informacioni i referuar në pikën 2, të këtij neni, duhet dërguar nëpërmjet një formulari të veçantë, për çdo vend të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, drejtpërdrejt në administratën tatimore ku tatimpaguesi është i regjistruar ose ku ka adresën e përhershme apo vendqëndrimin e zakonshëm.

5. Nëse ndryshohen të dhënat e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, tatimpaguesi, që lëshon fatura, detyrohet që të paraqesë informacionin lidhur me të dhënat e reja, në mënyrën e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, ose, në raste të veçanta, në përputhje me pikën 4, të këtij neni, jo më vonë se 72 orë pas ndodhjes së ndryshimit.

6. Pas regjistrimit të parë të të dhënave për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, sistemi informatik i administratës tatimore qendrore gjeneron kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit. Administrata tatimore qendrore lëshon një konfirmim të regjistrimit të vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, së bashku me kodin e tij, në formë elektronike. Ky konfirmim regjistrimi ruhet në platformën qendrore të faturave, në llogarinë e përdoruesit të tatimpaguesit.

7. Pas paraqitjes së të dhënave për vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit dhe përpara lëshimit të faturave, tatimpaguesi, që lëshon fatura, duhet të regjistrojë çdo pajisje elektronike të faturimit, në përputhje me pikën 4, të nenit 12, të këtij ligji. Përjashtimisht, në rastet e specifikuara në nenin 31, të këtij ligji, nëse tatimpaguesi, që lëshon fatura, nuk mund të kryejë testin hyrës nga pajisja fiskale në sistemin fiskal, ai mund të përdorë platformën qendrore të faturave për të regjistruar pajisjen elektronike të faturimit ose mund të dërgojë të dhënat për secilën pajisje fiskale nëpërmjet formularit të posaçëm, drejtpërdrejt në administratën tatimore ku është i regjistruar apo ku ka adresën e përhershme ose vendqëndrimin e zakonshëm.

8. Administrata tatimore qendrore mban të dhënat e të gjitha pajisjeve elektronike të faturimit të regjistruara. Tatimpaguesi, që lëshon fatura, detyrohet ta informojë administratën tatimore në rast të ndërprerjes së përhershme të punës së një pajisjeje elektronike të faturimit për arsye të zëvendësimit të saj me një të re, si rezultat i prishjes, vjedhjes apo çdo arsyeje tjetër, në përputhje me pikën 5, të këtij neni.

9. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim të dhënat, formën dhe procedurën për paraqitjen e të dhënave të përcaktuara në këtë nen.

## Neni 15

### **Regjistrimi i operatorëve**

1. Tatimpaguesi, që lëshon fatura, detyrohet që të paraqesë në administratën tatimore, duke përdorur platformën qendrore të faturave, të dhënat për çdo operator individual, duke përfshirë të dhënat mbi numrin unik të identifikimit dhe emrin e mbiemrin e operatorit, jo më vonë se 24 orë para fillimit të lëshimit të faturave nga secili operator individual.

2. Me përjashtim të pikës 1, të këtij neni, nëse tatimpaguesi, që lëshon fatura, nuk mund të përdorë platformën qendrore të faturave, në rastet e specifikuara në nenin 31, të këtij ligji, të dhënat e referuara në pikën 1, të këtij neni, duhen dërguar nëpërmjet një formulari të veçantë për secilin operator, drejtpërdrejt në administratën tatimore ku është i regjistruar, ku ka adresën e përhershme ose vendqëndrimin e zakonshëm.

3. Pas regjistrimit të të dhënave, sistemi informatik i administratës tatimore qendrore gjeneron kodin e operatorit, që shoqërohet me numrin e tij personal të identifikimit, nëse operatori është individ, ose me NIPT/NUIS, nëse operatori është tatimpagues që ofron shërbime konsulence fiskale, tatimore, apo kontabiliteti. Përjashtimisht, për pajisjet e

vetëshërbimit (automatët), kodi i operatorit lidhet me numrin unik të identifikimit të tatimpaguesit që lëshon fatura.

4. Administrata tatimore qendrore i jep tatimpaguesit, që lëshon fatura, konfirmimin e regjistrimit të operatorit, së bashku me kodin përkatës, në formë elektronike. Ky konfirmim regjistrimi ruhet në platformën qendrore të faturave, në llogarinë e përdoruesit të tatimpaguesit, që lëshon fatura.

5. Nëse një pajisje elektronike e faturimit përdoret nga më shumë se një operator për përpilimin dhe lëshimin e faturave, secili operator, si lëshues i faturës, duhet të identifikohet në sistemin fiskal me anë të kodit të vet për çdo faturë që lëshon.

6. Tatimpaguesi, që lëshon fatura, duhet të paraqesë në administratën tatimore informacionin për çdo ndryshim të të dhënave të operatorëve, në mënyrën e përcaktuar në pikat 1 e 2, të këtij neni, brenda 24 orëve pas ndodhjes së ndryshimit.

7. Nëse një person është operator i autorizuar për lëshim të faturave për dy ose më shumë tatimpagues, që lëshojnë fatura, ai do të përdorë të njëjtin kod kur futet në sistemin fiskal.

8. Një operator mund të futet në sistemin fiskal dhe të fillojë lëshimin e faturave në emër dhe për llogari të tatimpaguesit, që lëshon fatura, vetëm nëse tatimpaguesi e ka regjistruar atë si operatorin e vet, në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni.

9. Ministri përgjegjës për financat, me udhëzim, përcakton formularin dhe procedurën për paraqitjen e të dhënave për operatorët e referuar në këtë nen.

#### Neni 16

#### **Regjistrimi i prodhuesve dhe mirëmbajtësve të software-ëve**

1. Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së ofrimit të zgjidhjeve software-ike ose shërbimeve të mirëmbajtjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, prodhuesit dhe mirëmbajtësit e zgjidhjeve software-ike, duhet të regjistrohen në mënyrë elektronike në regjistrin e prodhuesve ose të mirëmbajtësve software-ike të AKSHI-t, duke përdorur platformën qendrore të faturave.

2. Prodhuesi ose mirëmbajtësi i zgjidhjeve software-ike, të referuar në pikën 1, të këtij neni, detyrohet të certifikohet nga AKSHI, në bashkëpunim me administratën tatimore qendrore, përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së ofrimit të këtyre zgjidhjeve software-ike ose shërbimeve të mirëmbajtjes në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Prodhuesit e zgjidhjeve software-ike duhet të regjistrojnë tek AKSHI, sipas mënyrës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, edhe informacionin për zgjidhjet e veta software-ike.

4. Regjistrimi, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk e zëvendëson detyrimin për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit apo administratën tatimore të subjekteve që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi apo aktet nënligjore përkatëse.

5. Pas regjistrimit, sistemi informatik i AKSHI-t gjeneron kodin e subjektit të referuar nën pikën 1, të këtij neni, dhe kodin e zgjidhjes software-ike. Këto kode duhet të integrohen në zgjidhjen software-ike nga prodhuesit e software-ëve përpara dorëzimit të tatimpaguesit, që lëshon fatura, në mënyrë që sistemi fiskal të identifikojë prodhuesin dhe zgjidhjen software-ike të përdorur gjatë çdo dërgimi të faturave në procedurën e fiskalizimit.

6. AKSHI i jep në formë elektronike, subjektit të përcaktuar nën pikën 1, të këtij neni, certifikatën dhe kodin e regjistrimit të zgjidhjes software-ike. Kjo certifikatë ruhet në platformën qendrore të faturave, në llogarinë e përdoruesit të subjektit.

7. Tatimpaguesi, që lëshon faturë, nuk mund të lëshojë fatura nëse prodhuesi i software-it dhe zgjidhja software-ike që përdor nuk janë regjistruar në regjistrin e referuar në pikat 1 e 3, të këtij neni, dhe certifikuar. Për këtë qëllim, çdo tatimpagues, që lëshon fatura, mund të kontrollojë nëpërmjet emërimit/emrit dhe mbiemrit apo numrit unik të identifikimit të

prodhuesit të software-it nëse ai prodhues dhe zgjidhja software-ike janë të regjistruar në regjistër.

8. Tatimpaguesi, që lëshon faturë, duhet të dorëzojë në mënyrë elektronike të dhënat për mirëmbajtësin e zgjidhjeve software-ike, të referuar në pikën 1, të këtij neni, duke përdorur platformën qendrore të faturave.

9. Tatimpaguesi, që lëshon fatura, dhe prodhuesi ose mirëmbajtësi i software-it janë përgjegjës për funksionimin e zgjidhjes software-ike. Për këtë qëllim, çdo prodhues ose mirëmbajtës i software-it, që është regjistruar në regjistër sipas pikës 1, të këtij neni, nëpërmjet platformës qendrore të faturave mund të verifikojë listën me emrin dhe numrin unik të identifikimit të gjithë tatimpaguesve që lëshojnë fatura, duke përdorur zgjidhjen e tyre software-ike ose që kanë dhënë informacion që ata përdorin shërbimet e tyre të mirëmbajtjes.

10. Me vendim të Këshillit të Ministrave, përcaktohen kushtet dhe procedurat që ndiqen për certifikimin e prodhuesve dhe mirëmbajtësit e zgjidhjeve software-ike si dhe detyrimet e rregullat e tjera procedurale për zbatimin e këtij neni

#### Neni 17

### **Regjistrimi i faturave në librin e shitjes dhe librin e blerjes**

1. Duke u mbështetur në të dhënat e paraqitura në administratën tatimore qendrore për të gjitha faturat e shitjeve dhe të blerjeve, nëpërmjet procedurës së fiskalizimit të faturave për çdo tatimpagues që lëshon faturë, në pajtim me këtë ligj, sistemi informatik i administratës tatimore qendrore gjeneron një libër të shitjeve dhe një libër të blerjeve, të cilët janë në dispozicion në platformën qendrore të faturave, në llogarinë e tatimpaguesve që lëshojnë faturë.

2. Çdo tatimpagues, që lëshon faturë, duhet të shqyrtojë të dhënat në librin e shitjeve dhe librin e blerjeve, deri në ditën e dhjetë të muajit, për faturat e lëshuara e të pranuar, që i përkasin muajit paraardhës, dhe, nëse është e nevojshme, t'i plotësojë ato me informacion shtesë. Pas përfundimit të kësaj procedure duhet të konfirmojë saktësinë e të dhënave.

3. Libri i shitjeve dhe libri i blerjeve në platformën qendrore të faturave duhet të jenë në dispozicion të tatimpaguesit, që lëshon fatura gjatë gjithë afatit kohor të përcaktuar për ruajtjen e faturave, sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

4. Ministri përgjegjës për financat përcakton, me udhëzim, procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e të dhënave në librin e shitjeve e në librin e blerjeve dhe procedurat e tjera të përcaktuara nga ky nen.

#### KREU VI

### **PROCEDURA E FISKALIZIMIT TË LËSHIMIT TË FATURAVE**

#### Neni 18

### **Pajisjet fiskale dhe zgjidhja software-ike për zbatimin e procedurës së fiskalizimit**

1. Tatimpaguesit e përcaktuar në nenin 4, të këtij ligji, që ushtrojnë veprimtari ekonomike, në shitjen me pakicë, në ofrimin e shërbimeve në vende apo njësi të hapura për publikun apo çdo lloj veprimtarie tjetër të ngjashme me para në dorë, duhet të instalojnë sistemin e fiskalizimit, sipas këtij ligji, përfshirë printerin nëse nuk është pjesë integrale e pajisjes fiskale si dhe të përdorin një zgjidhje të certifikuar software-ike. Përfshihen nga ky detyrim tatimpaguesit e përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji.

2. Pavarësisht përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, të gjithë tatimpaguesit që janë pajisur dhe kanë instaluar pajisjet fiskale përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdojnë përdorimin e tyre edhe me sistemin e ri të fiskalizimit, sipas këtij ligji. Sistemi i fiskalizimit detyrimisht mundëson ruajtjen e çdo transaksioni të kryer përmes këtyre pajisjeve fiskale, në memorie. Për të siguruar ndërfaqjen e të dhënave, për pajisjet fiskale ekzistuese, mund të përdoret një infrastrukturë e ndërmjetme (server i ndërmjetëm), e cila zhvillohet nga prodhuesit dhe mirëmbajtësit e zgjidhjeve software-ike, që duke siguruar që shkëmbimi i të dhënave të këtij serveri me sistemin e fiskalizimit bëhet në kohë reale dhe të dhënat shkëmbehen me autentifikim të sigurt që sigurohet nga certifikata elektronike e marrë nga tatimpaguesit pranë AKSHI-t.

3. Tatimpaguesit në përputhje me pikën 1 dhe 2, të këtij neni, për qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit të faturave të lëshuara, detyrohen që për çdo transaksion të lëshojnë një faturë për pagesë me para në dorë, nëpërmjet përdorimit të sistemit të fiskalizimit. Sistemi i fiskalizimit mundëson ruajtjen e çdo transaksioni në memorie, të nënshkruar elektronikisht për çdo faturë, duke përdorur certifikatën elektronike, sipas nenit 19, të këtij ligji, dhe lidhjen me internet për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore qendrore.

4. Tatimpaguesit që nuk përfshihen në pikën 1 dhe 2, të këtij neni, por që kanë detyrimin për lëshimin e faturës sipas nenit 4 të këtij ligji, duhet të pajisen me sistemin e fiskalizimit, që mundëson përdorimin e zgjidhjes software-ike të certifikuar, nënshkrimin elektronik të çdo fature, duke përdorur certifikatën elektronike, sipas nenit 19, të këtij ligji si dhe lidhjen me internet për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore qendrore, me qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit

5. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura, për qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit të faturave, duhet të përdorin një zgjidhje software-ike të certifikuar, që u mundëson atyre të veprojnë në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe që pamundëson kryerjen e veprimeve që shmanjin procedurën e fiskalizimit të faturës.

6. Me qëllim të zbatimit të pikës 5, të këtij neni, tatimpaguesi, që lëshon fatura, mund të testojë të dhënat e faturës dhe procedurën e fiskalizimit.

7. Me vendim të Këshillit të Ministrave, përcaktohet metodologjia dhe procedurat e monitorimit të qarkullimit për tatimpaguesit në sektorë të veçantë të ekonomisë. Metodologjia e testimit të të dhënave të faturës dhe procedurës së fiskalizimit nga tatimpaguesi që lëshon fatura, përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

#### Neni 19

#### **Certifikata elektronike**

1. Me qëllim të zbatimit të procedurës së fiskalizimit të faturës, tatimpaguesi, që lëshon fatura, duhet të pajiset me një certifikatë elektronike, e cila gjenerohet dhe lëshohet nga AKSHI, si institucioni qendror shtetëror që administron dhe mirëmban infrastrukturën qeveritare të çelësave publikë.

2. Certifikata elektronike e lëshuar nga AKSHI duhet ruajtur në një ambient fizik me nivel të lartë sigurie, duke mos cenuar konformitetin dhe konfidencialitetin e saj.

3. Për certifikatën elektronike të lëshuar aplikohet tarifa e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave për shërbimet elektronike të ofruara nga AKSHI, për subjektet sipas pikës 1 të këtij neni.

#### Neni 20

#### **Zbatimi i procedurës së fiskalizimit të faturës**

1. Tatimpaguesi, që lëshon fatura, duhet të nënshkruajë në mënyrë elektronike çdo faturë në momentin e lëshimit dhe ta dërgojë atë në administratën tatimore qendrore nëpërmjet lidhjes me internet, përpara se t'ia lëshojë blerësit.

2. Administrata tatimore qendrore duhet të verifikojë nëse janë dërguar të gjitha elementet e përcaktuara të faturës, nëse ajo është e nënshkruar elektronikisht, duke përdorur certifikatën elektronike të vlefshme, në përputhje me nenin 19, të këtij ligji dhe të kryejë kontrolle të tjera mbi saktësinë e faturës.

3. Nëse përmbushen plotësisht kushtet e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, administrata tatimore qendrore, gjeneron NIVF-në dhe ia kthen atë tatimpaguesit, nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur (internetit).

4. Nëse kushtet e pikës 2, të këtij neni, nuk përmbushen, administrata tatimore qendrore nuk mund ta përcaktojë NIVF-në dhe i dërgon tatimpaguesit, që lëshon fatura, një mesazh për refuzimin e përcaktimit të NIVF-së me përshkrimin e gabimit, nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur (internetit).

5. Fatura mund të njihet si dokument i vlefshëm, për qëllime të tatimit, vetëm pas zbatimit të procedurës së fiskalizimit dhe lëshimit të NIVF-së, si një e dhënë e detyrueshme e faturës që tregon se procedura e fiskalizimit është kryer me sukses. Përrjashtimisht nga përcaktimi i kësaj pike, një faturë mund të lëshohet pa NIVF-në, vetëm në rastet e përcaktuara në nenet 29, 30 dhe 31, të këtij ligji.

6. Subjektet e vetëfaturimit duhet të zbatojnë procedurën e fiskalizimit në mënyrën e përshkruar në pikat 1 deri në 5 të këtij neni.

7. Kur blerësit, që janë tatimpagues, subjekte të TVSH-së, të tatimit mbi fitimin ose tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, në përputhje me legjislacionet përkatëse në fuqi, marrin një faturë për importin e mallrave nga një shitës nga jashtë vendit ose një faturë elektronike për shërbime të marra nga një tatimpagues nga jashtë vendit, që nuk është subjekt i lëshimit të faturave, sipas këtij ligji, blerësit duhet të zbatojnë procedurën e fiskalizimit në mënyrën e përshkruar në pikat 1 deri në 5 të këtij neni.

8. Procedura e fiskalizimit të faturës në rast të vetëfaturimit, sipas pikës 5, të nenit 6, të këtij ligji, kryhet në kohën e vetëfaturimit, brenda afateve të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji.

9. Procedura e fiskalizimit të faturës në rast të vetëfaturimit, sipas pikës 2, të nenit 7, të këtij ligji, kryhet në kohën e vetëfaturimit, brenda afateve të referuara në pikat 2 e 3, të nenit 8, të këtij ligji.

10. Procedura e fiskalizimit të faturës për importet e mallrave, në rastet e parashikuara në pikën 7, të këtij neni, kryhet nga marrësi i mallrave në Republikën e Shqipërisë, bazuar në deklaratën doganore pas vendosjes së mallrave nën regjimin e hedhjes për qarkullim të lirë, por jo më vonë se tri ditë nga vendosja e mallrave në këtë regjim. Në rast të rishikimit të deklaratës doganore, si pasojë e rivlerësimit doganor ose kontrollit pas zhdoganimit, brenda afatit të përcaktuar në kodin doganor, blerësi që ka kryer procesin e fiskalizimit, bën menjëherë korrigjimin e të dhënave të faturës, bazuar në deklaratën doganore të rishikuar dhe e dërgon atë pranë administratës tatimore. Në rastin e furnizimit nga jashtë të shërbimeve, blerësi vendas i shërbimit, që ka marrë një faturë elektronike nga jashtë shtetit, kryen procedurën e fiskalizimit brenda afatit të referuar në pikën 3, të nenit 8, të këtij ligji.

11. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim, detyrimet e tatimpaguesit në procesin e fiskalizimit të faturës, procedurën dhe mekanizmat për zbatimin e saj dhe të dhënat shtesë, të kërkuara sipas këtij ligji.

## Neni 21

### **Shitjet nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automatët)**



1. Për zbatimin e procedurës së fiskalizimit të shitjeve nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automat), tatimpaguesi, që lëshon faturë, detyrohet të fiskalizojë çdo shitje, në momentin e shitjes, nëpërmjet dërgimit të të dhënave të shitjes në administratën tatimore qendrore. Me pajisje vetëshërbimi nënkuptohet një pajisje e vetëshërbimit, që shpërndan automatikisht mallra konsumi me futjen e parave, të xhetonave, kartave të kreditit ose debitit apo mjeteve të ngjashme, si dhe një pajisje vetëshërbimi që përdoret për pagimin e shërbimeve.

2. Tatimpaguesi, që lëshon faturë, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të mundësojë përdorimin e software-it për nënshkrimin elektronik të mesazheve mbi shitjen dhe të sigurojë lidhjen me internet për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore qendrore për zbatimin e procedurës së fiskalizimit të shitjeve nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit.

3. Pavarësisht nga pika 4, e neni 6, të këtij ligji, dërgimi i të dhënave mbi shitjet në administratën tatimore qendrore, në përputhje me pikat 1 e 2, të këtij neni, konsiderohet që të ketë përmbushur detyrimin e lëshimit të faturës, sipas këtij ligji. Tatimpaguesit, të cilët operojnë në sektorë të veçantë të ekonomisë, në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat dhe kryejnë shitje nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automat), duhet të mundësojnë printimin e faturës kur kryejnë shitje nëpërmjet këtyre pajisjeve. Në këtë rast printohet një faturë e thjeshtë, sipas nenit 11 të këtij ligji.

4. Detyrimet ligjore, që rrjedhin nga ky nen, zbatohen në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për financat.

#### Neni 22

#### **Procedura e thjeshtëzuar për fiskalizimin e faturave për pagesat me para në dorë**

1. Me përjashtim të neneve 16, 18 dhe 20, të këtij ligji, tatimpaguesit që lëshojnë fatura për pagesa me para në dorë, të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, mund të përdorin platformën qendrore të faturave si një alternativë për përpilimin dhe fiskalizimin e faturave të thjeshtuara, sipas nenit 11 të këtij ligji.

2. Tatimpaguesi, që lëshon fatura, duhet të printojë në letër dhe t'ia dorëzojë blerësit ose t'ia dërgojë me postë elektronike, në bazë të pëlqimit të blerësit, faturat e referuara në pikën 1 të këtij neni.

3. AKSHI lëshon një certifikatë elektronike, sipas nenit 19, të këtij ligji, për subjektet e pikës 1, të këtij neni, sipas kërkesës së tyre.

4. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim procedurën e aksesimit, përpilimit dhe fiskalizimit të faturës, sipas pikës 1 të këtij neni.

#### KREU VII

#### **MËNYRA E LËSHIMIT DHE DËRGIMIT TË FATURËS**

#### Neni 23

#### **Fatura për pagesat me para në dorë**

1. Fatura për pagesat me para në dorë duhet të printohet në letër, të përmbajë të gjitha të dhënat, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar, i nënshtrohet procedurës së fiskalizimit, sipas këtij ligji, dhe i dorëzohet blerësit në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve.

2. Në rastin e furnizimit të mallrave me transport, transportuesi duhet të mbajë faturën e lëshuar nga shitësi gjatë gjithë kohëzgjatjes së transportit të mallrave, nga pika e nisjes deri në destinacion ose deri në dorëzimin e mallrave blerësit dhe, sipas kërkesës së punonjësve të administratës tatimore qendrore, janë të detyruar ta vendosin këtë dokument në dispozicion të tyre.

3. Si përjashtim nga pika 1, e këtij neni, nëse ofrohen shërbime elektronike ose furnizimi i mallrave ose shërbimeve kontraktohet dhe paguhet nëpërmjet një aplikacioni celular, dyqani në internet apo të ngjashme, fatura nuk ka nevojë të printohet në letër, por mund t'i dërgohet blerësit ose marrësit të faturës nëpërmjet postës elektronike (e-mail) ose si faturë elektronike.

4. Nëse blerësi është individ ose person që nuk është tatimpagues që lëshon fatura, sipas nenit 4, të këtij ligji, atëherë dërgimi i faturës, sipas pikës 3, të këtij neni, mund të kryhet vetëm me pëlqimin e blerësit. Për blerës të tjerë, në rastin e referuar në pikën 3, të këtij neni, një faturë elektronike mund të lëshohet pa pëlqim të veçantë nga blerësi, në përputhje me nenin 28, të këtij ligji, nëse blerësi është i regjistruar në platformën qendrore të faturave, të referuar në nenin 26 të këtij ligji.

#### Neni 24

#### **Fatura elektronike për pagesa pa para në dorë**

1. Fatura për furnizimin e mallrave e të shërbimeve në transaksione, në të cilat shitësi dhe blerësi janë tatimpagues, subjekte të TVSH-së ose të tatimit mbi fitimin apo të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, në përputhje me ligjet përkatëse, duhet të lëshohet, dërgohet dhe pranohet si faturë elektronike, në përputhje me nenin 28, të këtij ligji, nëse fatura është paguar ose do të paguhet pa para në dorë.

2. Fatura elektronike, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të ketë të gjitha të dhënat e nevojshme dhe të lëshohet duke zbatuar procedurat e fiskalizimit, të përcaktuara me këtë ligj, duhet të jetë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në Standardet Shqiptare (SSH), siç janë publikuar nga institucioni përgjegjës për standardizimin, dhe procedurat në kreun VIII të këtij ligji.

3. Fatura elektronike, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet t'i dërgohet ose t'i vihet në dispozicion blerësit në momentin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji.

4. Në rastin e furnizimit të mallrave me transport, tatimpaguesi, që lëshon faturë, sipas pikës 1, të këtij neni, detyrohet të lëshojë një faturë elektronike dhe të zbatojë procedurën e fiskalizimit menjëherë përpara kryerjes së transportit të mallrave, të printojë në letër kodin QR, me të dhënat e përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, dhe t'ia dorëzojë atë transportuesit. Transportuesi duhet ta ruajë këtë dokument gjatë gjithë kohëzgjatjes së transportit të mallrave, nga pika e nisjes deri në destinacion ose derisa t'ia dorëzojë mallrat blerësit dhe detyrohet t'ua vendosë këtë dokument në dispozicion përfaqësuesve të administratës tatimore, sipas kërkesës.

5. Në të gjitha transaksionet e tjera pa para në dorë, kur blerësi nuk është tatimpagues, siç është përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, apo një organ publik, dhe kur ekziston detyrimi për të lëshuar një faturë sipas këtij ligji, fatura, që është paguar ose do të paguhet pa para në dorë mund të lëshohet si faturë elektronike. Blerësi mundet, por nuk është i detyruar ta pranojë si faturë elektronike, prandaj ajo mund të printohet në letër ose t'i dërgohet blerësit nëpërmjet postës elektronike (e-mail) me pëlqimin e tij. Përjashtimisht, pëlqimi i tij nuk është i nevojshëm, nëse blerësi është i regjistruar në platformën qendrore të faturave, të përmendur në nenin 26 të këtij ligji.

6. Tatimpaguesi, që lëshon fatura, mund të lëshojë dhe dërgojë fatura, sipas pikës 5, të këtij neni, kur lëshon fatura që janë paguar apo do të paguhet pa para në dorë, në rastin e eksportimit të mallrave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ose ofrimit të shërbimeve për blerësit jorezidentë. Nëse blerësi është rezident i një shteti anëtar të Bashkimit Europian, fatura mund të lëshohet si faturë elektronike vetëm me pëlqimin e blerësit.

7. Pëlqimi i blerësit, sipas pikave 5 ose 6, të këtij neni, duhet të jepet me shkrim ose me marrëveshje gjatë përpunimit të faturës ose kryerjes së pagesës së faturës së pranuar.

## Neni 25

### **Faturat elektronike në transaksionet me organet publike**

1. Faturat në transaksionet me organet publike duhet të lëshohen, dërgohen dhe pranohen si fatura elektronike, në përputhje me nenin 28 të këtij ligji.

2. Detyrimi për të lëshuar një faturë elektronike, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk zbatohet për faturat e lëshuara si rezultat i përmbushjes së një kontrate të prokurimit publik, ku prokurimi dhe përmbushja e kontratës deklarohen të jenë sekrete ose duhet të shoqërohen me masa të veçanta të sigurisë, në përputhje me ligjet përkatëse, rregulloret ose dispozitat administrative, dhe me kusht që interesa me rëndësi nuk mund të garantohen me masa më pak të ashpra.

## KREU VIII

### **DISPOZITA TË VEÇANTA PËR FATURAT ELEKTRONIKE**

## Neni 26

### **Platforma qendrore e faturave**

1. Ngarkohet AKSHI që të krijojë, zhvillojë, mirëmbajë dhe administrojë nga ana teknike platformën qendrore të faturave, nëpërmjet së cilës shkëmbehen faturat elektronike.

2. Tatimpaguesit, që regjistrohen në regjistrin e administratës tatimore qendrore si tatimpagues që lëshojnë fatura, sipas nenit 13, të këtij ligji, regjistrohet automatikisht në regjistrin e tatimpaguesve, që mbahet nga administrata tatimore qendrore, si lëshues dhe pranues të faturave elektronike.

3. Lëshuesit dhe marrësit e faturave elektronike, sipas pikës 2, të këtij neni, që kanë njësi të ndryshme organizative, janë të detyruar të paraqesin informacione për to në platformën qendrore të faturave brenda 24 orëve, para fillimit të lëshimit ose marrjes apo shkëmbimit të faturave elektronike nëpërmjet kësaj platforme.

4. Marrësit e faturave elektronike, të cilët nuk janë të regjistruar në regjistrin e administratës tatimore qendrore si tatimpagues që lëshojnë fatura, sipas nenit 13, të këtij ligji, duhet të marrin një certifikatë elektronike, sipas nenit 19, të këtij ligji, dhe nëpërmjet platformës qendrore të faturave të regjistrohen si marrës të faturave elektronike brenda 24 orëve përpara fillimit të marrjes së faturave elektronike nëpërmjet kësaj platforme.

5. Të gjitha faturat elektronike duhet të shkëmbehen nëpërmjet platformës qendrore të faturave pas zbatimit të procedurës së fiskalizimit, në përputhje me kreun VI të këtij ligji.

6. Platforma qendrore e faturave është pjesë e infrastrukturës shtetërore të teknologjisë së informacionit, që administrohet nga ana teknike nga AKSHI, dhe të dhënat që shkëmbehen nëpërmjet saj janë pronë e administratës tatimore qendrore.

7. Detyrimet ligjore, që rrjedhin nga ky nen, zbatohen në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

## Neni 27

### **Procedura e thjeshtuar për lëshimin, pranimin e faturave elektronike dhe për fiskalizimin**

1. Tatimpaguesit në rastet e lëshimit ose pranimit të faturave elektronike, sipas përcaktimeve të nenet 24 e 25, të këtij ligji, mund të përpilojnë, fiskalizojnë dhe dërgojnë këto fatura elektronike te blerësi ose t'i pranojnë faturat elektronike nëpërmjet platformës

qendrore të faturave. Kategoria e tatimpaguesve dhe kriteret e nevojshme, për qëllime të zbatimit të kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Lëshuesit dhe pranuesit e faturave elektronike, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të pajisen me certifikatë elektronike, sipas nenit 19, të këtij ligji, për shkëmbimin elektronik të dhënave.

3. Si përjashtim nga nenet 16, 18 e 20, të këtij ligji, lëshuesit e faturave elektronike, të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, nuk duhet të instalojnë pajisje të veçanta fiskale apo një zgjidhje të veçantë software-ike për zbatimin e procedurës së fiskalizimit, ose të paraqesin informacion në lidhje me mirëmbajtësin e zgjidhjes software-ike.

4. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim procedurat përkatëse për zbatimin e këtij neni.

#### Neni 28

### **Rregullat e përdorimit të faturave elektronike**

1. Faturat elektronike, të lëshuara sipas këtij ligji, duhet të jenë në përputhje me këtë ligj dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Standardet Shqiptare (SSH), apo dokumente të tjera të barasvlershme me to.

2. Vërtetësia e origjinës, integriteti i përmbajtjes dhe lexueshmëria e faturës, qoftë kjo në letër apo në formë elektronike, garantohen duke filluar nga momenti i lëshimit të saj deri në përfundimin e periudhës së ruajtjes së faturës.

3. Vërtetësia e origjinës sigurohet në mënyrë të tillë që lëshuesi të jetë i identifikueshëm ndërsa integriteti i përmbajtjes nënkupton që përmbajtja e faturës nuk është ndryshuar.

4. Tatimpaguesi, që lëshon fatura, garanton me anë të certifikatës elektronike termat dhe kushtet, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni.

5. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim zbatimin e këtij neni.

#### KREU IX

### **DISPOZITA TË VEÇANTA PËR PROCEDURËN E FISKALIZIMIT**

#### Neni 29

### **Ndërprerja e lidhjes elektronike (internetit)**

1. Përjashtimisht përcaktimeve në nenet 18, 20 e 21, të këtij ligji, në rast të ndërprerjes së lidhjes elektronike (internetit), tatimpaguesi, lëshon faturën, e cila përmban të dhënat e përcaktuara në kreun IV, të këtij ligji, me përjashtim të NIVF-së, dhe e printon faturën në letër.

2. Tatimpaguesi, që lëshon fatura, duhet që, brenda 48 orëve, duke filluar nga momenti i ndërprerjes së lidhjes, të vendosë një lidhje elektronike (interneti) dhe t'ia dorëzojë të gjitha faturat e lëshuara sipas pikës 1, të këtij neni, administratës tatimore qendrore, nëpërmjet një protokolli të veçantë, në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat, dhe pranuesit të faturës elektronike, në rastin e përmendur në nenet 24 e 25, të këtij ligji, në formën e një fature elektronike.

3. Faturat e lëshuara sipas pikës 1, të këtij neni, konsiderohen se janë fiskalizuar saktësisht nëse procesi i fiskalizimit është kryer brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Në mënyrë që procesi i përshkruar në pikat 1 deri në 3, të këtij neni, të jetë një përjashtim, tatimpaguesi, që lëshon fatura, duhet të sigurojë mbështetje të përshtatshme software-i dhe hardware-i për shkëmbimin dhe dërgimin e të dhënave në administratën tatimore qendrore dhe lidhje të përshtatshme elektronike (interneti).

5. Tatimpaguesi, që lëshon faturë, është përgjegjës për verifikimin e kapacitetit të duhur të rrjetit, që duhet përcaktuar në mënyrë të pavarur, bazuar në numrin e mesazheve për sekondë në momentin e ngarkesës maksimale.

6. Administrata tatimore qendrore u cakton një NIVF të gjitha faturave, sipas pikës 2, të këtij neni, dhe ia kthen tatimpaguesit, që lëshon fatura, si konfirmim të pranimit të faturave të dërguara me vonesë.

7. Nëse tatimpaguesi, që lëshon faturë, nuk mundet që në afatin e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, të rivendosë lidhjen elektronike (internetin) për arsye të nevojës për të ndryshuar pajisjen për vendosjen e lidhjes elektronike (internetit), pamundësisë për të vendosur lidhjen elektronike (internetin), për të cilën është përgjegjës ofruesi i këtij shërbimi, ose për arsye të forcës madhore, ai duhet të njoftojë administratën tatimore për këtë dhe të dërgojë dokumentacionin ose provat e tjera, që dëshmojnë pamundësinë e vendosjes së lidhjes elektronike (internetit), sipas udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat.

8. Për faturat, për të cilat nuk është përcaktuar detyrimi i dërgimit në formë elektronike, në përputhje me nenet 24 e 25, të këtij ligji, tatimpaguesi, që lëshon faturë, duhet që me kërkesë të blerësit të lëshojë një kopje në letër të faturës me NIVF, të përcaktuar në përputhje me pikën 6, të këtij neni, pasi është kryer procedura e mëvonshme fiskalizuese.

### Neni 30

#### **Ndërprerja e punës së pajisjes fiskale për zbatimin e fiskalizimit**

1. Nëse ndodh ndërprerja e plotë e punës së pajisjes fiskale, tatimpaguesi, që lëshon faturë, lëshon një faturë nga një bllok i veçantë faturash.

2. Blloku i veçantë i faturave përmban dy kopje për secilën faturë: origjinalin për konsumatorin dhe kopjen që mbetet në librin që duhet të mbahet nga tatimpaguesi. Drejtori i Përgjithshëm i administratës tatimore qendrore miraton formatin e faturës, e cila shtypet nga autoritetet tatimore apo nga subjekte private të autorizuar dhe shpërndahet nga autoritetet tatimore. Në rastet kur shtypja e faturës kryhet nga subjektet private, autorizimi lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i administratës tatimore qendrore.

3. Në rastin e referuar në pikën 1, të këtij neni, tatimpaguesi, që lëshon faturë, detyrohet që brenda pesë ditëve, nga e nesërmja e ditës kur pajisja fiskale ka ndaluar plotësisht së funksionuari, të mundësojë funksionimin e pajisjes për lëshimin e faturave fiskale ose të sigurojë një pajisje të re.

4. Brenda 5 ditëve pas afatit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, tatimpaguesi, që lëshon faturë, detyrohet t'i fusë të gjitha faturat në sistemin fiskal dhe t'i paraqesë ato në administratën tatimore qendrore, nëpërmjet lidhjes elektronike (internetit), nëpërmjet një protokolli të veçantë, në përputhje me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

5. Administrata tatimore qendrore u cakton NIVF-në të gjitha faturave të referuara në pikën 4, të këtij neni, dhe ia kthen ato tatimpaguesit, që lëshon faturë, si konfirmim për pranimin e faturave të dorëzuara me vonesë.

6. Menjëherë pas marrjes së NIVF-ve, tatimpaguesi, që lëshon faturë, detyrohet që ta shtojë informacionin lidhur me NIVF-të e marra në kopjet e faturave në bllokun e veçantë të faturave, sipas pikës 1, të këtij neni, dhe t'ua dërgojë marrësve të faturave elektronike, në rastet e neneve 24 e 25, të këtij ligji, faturën me NIVF-në në formën e faturës elektronike.

7. Për faturat, për të cilat nuk është përcaktuar detyrimi për dorëzimin e faturave elektronike, në përputhje me nenet 24 e 25, të këtij ligji, tatimpaguesi, që lëshon faturë, detyrohet që me kërkesë të blerësit të lëshojë një kopje në letër të faturës me NIVF-në nga pajisja elektronike e faturimit, pasi është kryer procedura e mëvonshme fiskalizuese.

8. Kriteret, që duhet të plotësojnë subjektet private për shtypjen e faturës, kushtet e shtypjes, standardet e sigurisë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Procedura e fiskalizimit të mëvonshëm të faturave të lëshuara sipas këtij neni përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

#### Neni 31

### **Zbatimi i procedurës së fiskalizimit në zonat ku nuk është e mundur të vendoset një lidhje për shkëmbimin e të dhënave**

1. Nëse tatimpaguesi, që lëshon faturë, ushtron veprimtarinë e vet tregtare në ambiente biznesi, të cilat ndodhen në një zonë ku nuk është e mundur të vendoset lidhja elektronike (interneti) për shkëmbimin e të dhënave me administratën tatimore qendrore, tatimpaguesi, që lëshon faturë, do të zbatojë procedurën e fiskalizimit të faturave për atë pjesë të aktivitetit të tij tregtar nëpërmjet lëshimit të faturës me të dhënat e përcaktuara në kreun IV, të këtij ligji, pa të dhënat e NIVF-së, dhe është i përjashtuar nga detyrimi për të lëshuar fatura elektronike, sipas neneve 24 e 25 të këtij ligji, deri sa të krijohet mundësia e lidhjes elektronike (internetit).

2. Tatimpaguesi, që lëshon faturë, i deklaron administratës tatimore pamundësinë për të vendosur lidhjen elektronike (internetin) për shkëmbimin e të dhënave dhe kjo deklaratë verifikohet nga administrata tatimore qendrore, bazuar në informacionin nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me afat të vlefshmërisë për një vit.

3. Tatimpaguesi, që lëshon faturë, në rastin e përmendur në pikën 1, të këtij neni, detyrohet:

a) të dorëzojë në administratën tatimore qendrore të dhënat e përcaktuara në kreun V, të këtij ligji, nëpërmjet platformës qendrore të faturave, me postë ose personalisht nëpërmjet formularit përkatës në administratën tatimore ku është regjistruar ose ku ka adresën e përhershme apo vendqëndrimin e zakonshëm;

b) të pajiset me pajisje fiskale dhe zgjidhje software-ike, në përputhje me nenin 18 të këtij ligji;

c) të pajiset me certifikatë elektronike, sipas nenit 19, të këtij ligji;

ç) deri në datën 10, të muajit, të paraqesë në administratën tatimore të gjitha faturat e lëshuara në muajin paraardhës, nëpërmjet një memorieje portative ruajtëse të rishkrueshme ose nëpërmjet platformës qendrore të faturave.

4. Administrata tatimore qendrore u cakton NIVF-në të gjitha faturave të lëshuara, të referuara në shkronjën “ç”, të pikës 3, të këtij neni, dhe ia kthen ato tatimpaguesit, që lëshon fatura, si konfirmim i pranimit të faturave të paraqitura me vonesë.

5. Tatimpaguesi, që lëshon faturë, detyrohet që të shtojë informacionin mbi NIVF-në e marrë nga administrata tatimore qendrore, sipas pikës 4, të këtij neni, në të gjitha faturat e lëshuara, duke përdorur zgjidhjen software-ike, brenda 5 ditëve nga marrja e NIVF-së.

6. Me kërkesë të blerësit, tatimpaguesi, që lëshon faturë, detyrohet t'i japë një kopje në letër të faturës me NIVF-në të shënuar në faturë, në përputhje me pikën 5 të këtij neni.

7. Ministri përgjegjës për financat nxjerr udhëzim për detyrimet e tatimpaguesit, që lëshon faturë, sipas këtij neni, dhe mënyrës së dërgimit të të dhënave të referuara në pikat 3 e 4 të këtij neni.

#### Neni 32

### **Fiskalizimi i faturave korrigjuese/saktësuese**

1. Të gjitha detyrimet e përcaktuara në dispozitat e këtij ligji për lëshimin e faturave dhe procedurën e fiskalizimit zbatohen, sipas nevojës, edhe për lëshimin e faturave korrigjuese/saktësuese, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

2. Fatura korigjuese/saktësuese duhet të përmbajë një referencë të fatura origjinale, që korigjohet.

### Neni 33 **Njoftimi për faturën**

1. Tatimpaguesi, që lëshon faturë, detyrohet të afishojë një njoftim në secilën pajisje elektronike të pagesës ose në një vend tjetër të dukshëm në ambientet e brendshme të biznesit, që tregon detyrimin për të lëshuar faturë si dhe detyrimin e blerësit për të marrë dhe ruajtur faturën.

2. Si përjashtim nga pika 1, e këtij neni, tatimpaguesi, që lëshon faturë, i cili zbaton procedurën e fiskalizimit të shitjeve nëpërmjet pajisjeve të vetëshërbimit (automat), është i detyruar të afishojë në çdo pajisje vetëshërbimi një njoftim për fiskalizimin e shitjeve nëpërmjet këtyre pajisjeve.

3. Ministri përgjegjës për financat përcakton, me udhëzim, përmbajtjen dhe pamjen e njoftimit të përmendur në pikat 1 e 2 të këtij neni.

### Neni 34 **Detyrimet e blerësit**

1. Blerësi, ose çdo marrës i faturës të lëshuar për pagesë me para në dorë, është i detyruar të mbajë me vete faturën e lëshuar deri në 30 metra pas largimit nga vendi i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit.

2. Nëse i kërkohet, blerësi, është i detyruar t'i tregojë faturën e lëshuar personit të autorizuar të administratës tatimore qendrore.

### Neni 35 **Verifikimi i faturës**

1. Të gjithë blerësit ose marrësit e faturave mund të verifikojnë nëse fatura e tyre është fiskalizuar dhe raportuar në administratën tatimore qendrore brenda 60 ditëve, nga data e lëshimit të faturës.

2. Verifikimi bëhet nëpërmjet platformës qendrore të faturave ose nëpërmjet një aplikacioni special, duke skanuar kodin QR në faturë apo duke futur në mënyrë manuale disa elemente të faturës.

3. Faturat e lëshuara në rastet e referuara në nenet 29, 30 e 31, të këtij ligji, mund të dorëzohen nga blerësit ose marrësit e faturës në zyrat përkatëse të administratës tatimore qendrore për qëllime verifikimi.

4. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim mënyrën e verifikimit të faturave të lëshuara sipas këtij neni.

### Neni 36 **Ruajtja e faturave**

Tatimpaguesi, që lëshon faturë, duhet të marrë masa për ruajtjen e faturave të lëshuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore dhe legjislacionin në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar.

## KREU X REGJISTRIMI I TË DHËNAVE PËR PAGESAT

## ME DHE PA PARA NË DORË

### Neni 37

#### **Subjektet që ofrojnë shërbime të pagesave dhe procedurat për regjistrimin e pagesave pa para në dorë**

1. Bankat, institucionet e tjera financiare jobankare dhe subjekte të tjera, të cilat ofrojnë shërbime të pagesave pa para në dorë të faturave elektronike, të lëshuara në transaksione ndërmjet tatimpaguesve ose ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, për të cilat tatimpaguesi, që lëshon faturë, ka zbatuar procedurën e fiskalizimit, detyrohen të regjistrojnë pagesat e kryera dhe, në mënyrë elektronike, të njoftojnë administratën tatimore qendrore në fund të çdo dite pune për çdo faturë individuale elektronike të paguar gjatë asaj dite.

2. Subjektet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, detyrohen të përdorin një pajisje elektronike, të instalojnë një zgjidhje software-ike të certifikuar ose një sistem të integruar kompjuterik të certifikuar apo të përdorin një aplikacion web të certifikuar (Cloud), që mundëson lidhjen e faturave elektronike të lëshuara dhe të dhënave të pagesës, si dhe shkëmbimin e mesazheve elektronike me administratën tatimore, nëpërmjet një rrjeti të sigurt për transferimin elektronik të të dhënave përmes lidhjes elektronike (internetit). Këto subjekte duhet të dorëzojnë pranë administratën tatimore qendrore informacionin për mirëmbajtësin e zgjidhjes software-ike të certifikuar, të përdorur, sipas përcaktimeve në nenin 16 të këtij ligji.

3. Subjektet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mund të aksesojnë sistemin fiskal për shkëmbimin e mesazheve mbi pagesat e realizuara nëpërmjet përdorimit të një certifikate elektronike, në përputhje me nenin 19, të këtij ligji. Kur këto subjekte kryejnë pagesa të faturave elektronike në emër dhe për llogari të tyre ose në emër dhe për llogari të klientëve të tyre, duhet të dërgojnë një mesazh për pagesat e kryera në administratën tatimore nëpërmjet lidhjes elektronike (internetit) në fund të çdo dite pune.

4. Të dhënat, të cilat për nevoja të regjistrimit të pagesave i dërgohen administratës tatimore qendrore sipas mënyrës së përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3, të këtij neni, duhet të përmbajnë, të paktën, elementet e mëposhtme:

- a) numrin unik të identifikimit të paguesit (blerësit të mallrave ose shërbimeve);
- b) numrin unik të identifikimit të subjektit që ofron shërbimet e pagesës, sipas pikës 1 të këtij neni;
- c) NIVF-në e faturës së paguar apo, në raste të veçanta, NSLF-në, nëse në faturë nuk ka NIVF, në përputhje me nenin 29 të këtij ligji;
- ç) shumën e paguar;
- d) datën e pagesës.

5. Nëse subjektet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, nuk kanë në dispozicion të tyre të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 4, të këtij neni, për pagimin e faturave elektronike në transaksione ndërmjet tatimpaguesve ose ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, detyrohen ta marrin këtë informacion nga blerësi dhe të mos e kryejnë pagesën derisa blerësi të paraqesë të gjitha të dhënat e kërkuara.

6. Pas marrjes së mesazhit elektronik, administrata tatimore qendrore kontrollon në mënyrë automatike nëse janë dërguar të gjitha të dhënat e kërkuara, nëse të dhënat janë të sakta dhe, pastaj, regjistron në bazën e saj të të dhënave kryerjen e pagesës së faturës elektronike të fiskalizuar. Pas kryerjes së verifikimit, administrata tatimore qendrore u kthen subjekteve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, mesazhin mbi pranimin me sukses të informacionit për pagesën, nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur (internetit).

7. Nëse verifikimi nuk ka qenë i suksesshëm, administrata tatimore qendrore i kthen një mesazh subjektit të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, për regjistrimin e pasuksesshëm të



pagesës, së bashku me një shpjegim për gabimet, nëpërmjet lidhjes elektronike të vendosur (internetit). Nëse konstatohet ndonjë gabim, si pasojë e përgjegjësisë së subjektit, që ofron shërbime pagese, ky i fundit detyrohet të korrigjojë gabimin dhe të përsërisë procedurën, por, nëse gabimi nuk është shkaktuar me fajin e tij, ai detyrohet që, për këtë, të informojë blerësin për gabimin brenda 24 orëve nga pranimi i mesazhit. Blerësi detyrohet të korrigjojë gabimin dhe të informojë për këtë subjektin, që ofron shërbime pagese, i cili duhet të përsëritë procedurën sipas pikës 3 të këtij neni.

8. Si përjashtim nga pika 1, e këtij neni, nëse pagesa është kryer nëpërmjet një ndërmjetësi që nuk është i vendosur në Republikën e Shqipërisë, nëse pagesa pa para në dorë është kryer nga blerësi direkt, pa ndërmjetës, nëse pagesa është kryer në bazë të një fature të lëshuar nga blloku i veçantë i faturave, sipas nenit 30, të këtij ligji, ose nëse pagesa është kryer sipas një oferte dhe përpara lëshimit të faturës elektronike, në përputhje me pikën 1, të nenit 7, të këtij ligji, atëherë vetë tatimpaguesi, që lëshon faturë, duhet që nëpërmjet platformës qendrore të faturave të regjistrojë të gjitha pagesat e pranuar, jo më vonë se ditën e dhjetë të muajit pasardhës, për të gjitha pagesat e kryera në muajin paraardhës.

9. Sipas mënyrës së përcaktuar në pikën 8, të këtij neni, tatimpaguesi, që lëshon faturë, detyrohet të veprojë edhe në rast të kryerjes së pagesës nëpërmjet shkëmbimit, transferimit të të drejtave ose detyrimeve, heqjes dorë nga detyrimi dhe të ngjashme.

10. Të dhënat e pagesës, sipas këtij neni, dërgohen për të gjitha pagesat, pavarësisht nëse është paguar e gjithë shuma e faturës ose vetëm një pjesë e saj. Përjashtimisht, tatimpaguesi, që lëshon faturë, që regjistron vetë pagesat e marra, në përputhje me pikën 8, të këtij neni, shënon shumën totale të regjistruar për secilën faturë elektronike të muajit paraardhës.

11. Të gjitha detyrimet e përcaktuara në këtë nen zbatohen në mënyrën e duhur edhe në rast të anulimit apo ndryshimit të pagesës së bërë dhe për rimbursimin e pjesshëm ose të plotë të shumës së paguar për një faturë elektronike individuale. Nëse bëhet rimbursim i shumës së paguar, dërgohet një mesazh me të njëjtin informacion, sipas pikës 4, të këtij neni, me parashenjë të shumës negative të shumës së kthyer.

12. Detyrimet ligjore, që rrjedhin nga ky nen, zbatohen në përputhje me udhëzimin përkatës të ministrit përgjegjës për financat.

#### Neni 38

### **Procedurat për regjistrimin në arkë, për pagesat me para në dorë**

Tatimpaguesi, para lëshimit të faturës së parë, në fillim të çdo dite pune regjistron informacionin mbi shumën fillestare të parave të çeljes së arkës për çdo pajisje elektronike të faturimit, nëpërmjet lidhjes elektronike (internetit) të vendosur me administratën tatimore qendrore. Tatimpaguesi regjistron në të njëjtën mënyrë edhe çdo shtim ose tërheqje të shumës në arkë gjatë ditës së punës

#### KREU XI FATURA SHOQËRUESE

#### Neni 39

### **Tatimpaguesit, që lëshojnë faturë shoqëruese**

1. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura shoqëruese, janë tatimpagues që lëshojnë fatura sipas nenit 4, të këtij ligji, kur ata transportojnë mallra nga një vend në një tjetër në territorin e Republikës së Shqipërisë, pa ndryshim të pronësisë.

2. Qëllimi i lëshimit të faturës shoqëruese nuk është krijimi i detyrimit tatimor, por monitorimi i lëvizjes së mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

3. Fatura shoqëruese lëshohet nga tatimpaguesi sipas pikës 1, të këtij neni, menjëherë përpara transportit të mallrave nga një vend në një tjetër, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Fatura shoqëruese origjinale, riprodhuar si kod QR, duhet të shoqërojë lëvizjen e mallrave deri në destinacion.

4. Tatimpaguesit, që lëshojnë faturë shoqëruese, nuk duhet të regjistrohen në mënyrë të veçantë në regjistrin e administratës tatimore qendrore si lëshues të faturave shoqëruese përpara fillimit të lëshimit të faturave shoqëruese, por duhet të regjistrojnë vendin e ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga kryhet dërgimi i mallrave, në përputhje me përcaktimet e nenit 14 të këtij ligji.

5. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura shoqëruese, duhet të regjistrojnë informacionin mbi operatorin që lëshon faturat shoqëruese, në përputhje me përcaktimet e nenit 15 të këtij ligji.

6. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura shoqëruese, duhet të regjistrojnë informacionin për mirëmbajtësin e zgjidhjes software-ike, në përputhje me përcaktimet e nenit 16 të këtij ligji.

#### Neni 40

##### **Të dhënat e detyrueshme të faturës shoqëruese**

1. Fatura shoqëruese e lëshuar duhet të përpilohet në formën e përcaktuar me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat dhe duhet të përmbajë, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

- a) titullin “Faturë shoqëruese”;
- b) datën dhe kohën e lëshimit të faturës shoqëruese (orën dhe minutat);
- c) numrin e faturës shoqëruese;
- ç) numrin unik të identifikimit të tatimpaguesit, që lëshon fatura shoqëruese;
- d) emrin/emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, që lëshon fatura shoqëruese;
- dh) adresën e nisjes së mallrave;
- e) adresën e destinacionit të mallrave;
- ë) kodin e operatorit, të lëshuar në përputhje me nenin 15 të këtij ligji;
- f) kodin e vendit të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, të lëshuar në përputhje me nenin 14 të këtij ligji;
- g) datën e transportit të mallrave;
- gj) sasinë dhe përshkrimin e mallrave që transportohen;
- h) emrin/emrin dhe mbiemrin, adresën dhe numrin unik të identifikimit të transportuesit, nëse transportuesi është i ndryshëm nga tatimpaguesi, që lëshon fatura shoqëruese;
- i) numrin e targave të automjetit me të cilin transportohen mallrat;
- j) numrin identifikues të veçantë të faturës shoqëruese (NIVFSH), i shprehur si shenjë alfanumerike;
- k) numrin e sigurisë së lëshuesit të faturës shoqëruese (NSLFSH), i shprehur si shenjë alfanumerike;
- l) kodin QR, që përmban të dhënat e përcaktuara me udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

2. Tatimpaguesi, që lëshon faturën shoqëruese, pasi procedura e fiskalizimit është kryer me sukses, duhet të printojë vetëm kodin QR, sipas shkronjës “I”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Neni 12, i këtij ligji, zbatohet edhe për përcaktimin e numrit të faturës shoqëruese.

#### Neni 41

##### **Zbatimi i procedurës së fiskalizimit të faturës shoqëruese**

1. Tatimpaguesit, që lëshojnë fatura shoqëruese, duhet të instalojnë një pajisje elektronike dhe një printer, nëse pajisja dhe printeri nuk janë të integruara, për të printuar kodin QR të faturës shoqëruese, një zgjidhje software-ike, si dhe të sigurojnë lidhjen elektronike

(internetin) për shkëmbimin elektronik të të dhënave me administratën tatimore qendrore, në mënyrë që të kryhet procedura fiskalizuese për lëshimin e faturës shoqëruese.

2. Procedura e fiskalizimit, marrja e certifikatës elektronike, si dhe dispozitat e veçanta të procedurës së fiskalizimit për tatimpaguesit, që lëshojnë fatura shoqëruese, bëhet në përputhje me nenet 18, 19, 20, 29, 30 dhe 31 të këtij ligji.

#### Neni 42

#### **Detyrime të tjera**

1. Përpara transportimit të mallrave nga një vend i ushtrimit të veprimtarisë së biznesit të tatimpaguesit te një tjetër, kodi QR i faturës shoqëruese duhet të printohet në letër dhe duhet të shoqërojë mallrat gjatë gjithë kohës së transportit, nga vendi i nisjes deri në destinacion.

2. Me kërkesë të punonjësit të administratës tatimore, tatimpaguesi ose transportuesi duhet të tregojë kodin QR të faturës shoqëruese për inspektim.

3. Kodi QR, i shtypur në letër, pas kryerjes së transportit mbahet në vendin e destinacionit të mallrave.

4. Tatimpaguesi, që lëshon fatura shoqëruese, duhet t'i ruajë këto për, të paktën, 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit fiskal, të cilit i përkasin dokumentet ose në të cilin janë lëshuar faturat shoqëruese, në letër apo në formë elektronike.

#### KREU XII

#### DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

#### Neni 43

#### **Autoriteti përgjegjës**

Ngarkohen për zbatimin dhe administrimin e këtij ligji administrata tatimore dhe AKSHI.

#### Neni 44

#### **Sanksionet**

Çdo veprim ose mosveprim i kryer nga tatimpaguesi, që bie ndesh me dispozitat e këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet si e tillë në përputhje me parashikimet e legjislationit në fuqi për procedurat tatimore.

#### Neni 45

#### **Mbrojtja e të dhënave**

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen duke respektuar dispozitat e ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Të dhënat personale, të mbledhura për qëllim të lëshimit të faturës dhe kryerjes së regjistrimeve të pagesave, mund të përdoren vetëm për këtë qëllim dhe për qëllim të këtij ligji ose për qëllime të tjera, që janë në përputhje me qëllimin e mbledhjes së këtyre të dhënave.

3. Marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet blerësit ose klientit dhe ndërmjetësve të teknologjisë së informacionit ose tatimpaguesve, që lëshojnë fatura, dhe ofruesve të shërbimeve të teknologjisë së informacionit, apo pagesit të faturës elektronike dhe ndërmjetësit financiar, në rolin e administratorit dhe përpunuesit të të dhënave personale, të cilat përpunohen gjatë procedurës së lëshimit, marrjes, dërgimit, ruajtjes dhe përpunimit të faturave dhe procedurës së pagesave të faturave elektronike, rregullohen në përputhje me legjislationin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Të gjitha çështjet e tjera, që nuk mbulohen nga ky ligj, i nënshtrohen dispozitave të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore dhe dispozitave përkatëse të ligjeve të tjera në fuqi.

#### Neni 46

#### **Dispozitat kalimtare**

1. Për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri më 31 mars 2020, tatimpaguesit e rinj të regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe administratës tatimore, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri më 31.3.2020, për çdo transaksion me para në dorë, lëshojnë faturë ose kupon ose dëftesë tatimore, si dhe dorëzojnë librin e blerjeve dhe librin e shitjeve, në formën dhe procedurën e përcaktuar në këtë ligj dhe/ose legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore dhe legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar. Nga data 1 prill 2020 deri në fillimin e efekteve, sipas nenit 48, të këtij ligji, këta tatimpagues mund të lëshojnë fatura në përputhje me këtë ligj ose kuponëve tatimorë dhe/ose dokumenteve të tjera, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.

2. Për periudhën nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri në fillimin e efekteve, sipas nenit 48, të këtij ligji, të gjithë tatimpaguesit e tjerë, subjekt i këtij ligji, të cilët kryejnë transaksione me para në dorë, mund të lëshojnë fatura në përputhje me këtë ligj ose kuponëve tatimorë dhe/ose dokumenteve të tjera, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.

3. Për periudhën, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji e deri në fillimin e efekteve, sipas nenit 48, të këtij ligji, të gjithë tatimpaguesit e tjerë, të cilët kryejnë transaksione pa para në dorë, zbatojnë të gjitha detyrimet, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimit mbi vlerën e shtuar.

4. Tatimpaguesit dhe administrata tatimore marrin të gjitha masat për kryerjen e testimit të sistemit elektronik, lidhur me procedurat e fiskalizimit të lëshimit të faturave, sipas parashikimeve të kreut V dhe nenit 18, të këtij ligji, që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 47

#### **Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Ngarkohen Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për financat për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e tij.

2. Përfshihet përcaktimi të pikës 1, të këtij neni, aktet nënligjore për zbatimin e neneve 26, 27, 28, 37, 40, 41 dhe 42 të këtij ligji, nxirren jo më vonë se data 1 qershor 2020.

#### Neni 48

#### **Hyrja në fuqi**

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Përfshihet pikës 1 të këtij neni, në varësi të llojit të transaksionit, ky ligj i fillon efektet sipas grafikut të përcaktuar në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të kësaj pike:

a) për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021.

b) për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 korrik 2021.

c) për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit, pavarësisht përgjegjësisë tatimore apo qarkullimit vjetor të realizuar, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 shtator 2021.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 108/2020 datë 29.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 146, datë 07.08.2020)

KRYETARI  
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 18.12.2019

**Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 3, datë 20.01.2020**

**Ndryshuar me:**

- Ligj Nr. 108/2020 datë 29.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 146, datë 07.08.2020